



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 44 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008, të nenit 38, paragrafi 38.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010 dhe të nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/15 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit, e cila do të mbahet më 05.05.2023, dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe statusit të pronës komunale në Zonën Industriale;
2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në lagjet "Bregu i Diellit", "Fusha e Pajtimit" dhe "Hajvalia".

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-85604/23, më 28.04.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>